

RELACION SHPJEGUES
PËR PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE PËRGJEGJËSITË E MEKANIZMIT
TË KOORDINUAR TË REFERIMIT TË RASTEVE TË DHUNËS NDAJ GRAVE
DHE DHUNËS NË FAMILJE DHE BASHKËRENDIMIN E PUNËS SË
AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektvendimi ka për qëllim forcimin e mekanizmave për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përmes krijimit dhe funksionimit të një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse dhe organizatave të shoqërisë civile në nivel vendor, bazuar në një qasje të integruar dhe me në qendër viktimën.

Ky projektvendim hartohet në zbatim të pikës 4, të nenit 56, të ligjit nr.11/2026, “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, i cili parashikon detyrimin e Këshillit të Ministrave të përcaktojë përbërjen, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.

Në këtë kuadër, objektivi kryesor i këtij projektvendimi është rregullimi i plotë i funksionimit të MKR-së në nivel vendor, pranë çdo bashkie përmes:

- përcaktimit të rolit dhe përbërjes së tij;
- qartësimin të përgjegjësisë të institucioneve pjesë të tij;
- vendosjes së procedurave standarde për bashkërendimin dhe koordinimin ndërinstitutional.

Nëpërmjet këtyre dispozitave synohet rritja e efektivitetit në parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe garantimi i një përgjigjeje të koordinuar, në kohë dhe të orientuar drejt nevojave të viktimës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i projektvendimit kontribuon në realizimin e prioriteteve të programit politik qeverisës, në veçanti në drejtim të forcimit të mbrojtjes sociale dhe mbështetjes për gratë dhe vajzat në situatë dhune, përmes rritjes së aksesit në shërbime të integruara dhe të koordinuara në nivel vendor.

Projektvendimi është në përputhje me:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, miratuar me Vendimin nr. 88, datë 22.02.2023, të Këshillit të Ministrave, e cila thekson rëndësinë e barazisë gjinore dhe parimit të tolerancës zero ndaj dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”

- Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023, në kuadër të Grupkapitullit I “Themelorët”, i cili parashikon forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave;
- Angazhimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), si dhe kontribuon në përmbushjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht Objektivit 5 për barazinë gjinore dhe Objektivit 16 për drejtësi dhe institucione të forta.

Gjithashtu është në linjë me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 dhe planin e saj të veprimit, duke kontribuar në arritjen e objektivave për parandalimin dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe në forcimin e mekanizmave institucionale për mbrojtjen e viktimave.

Projektvendimi nuk është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Parandalimi, eliminimi dhe mbrojtja nga të gjitha format e dhunës ndaj grave në sferën publike dhe private, si dhe dhuna në familje, përbën një ndër prioritetet kryesore të politikave publike dhe një kusht thelbësor për garantimin e të drejtave të njeriut dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Në këtë kuadër dhe në funksion të zbatimit efektiv të ligjit nr. 11/2026, “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, paraqitet e domosdoshme miratimi i akteve nënligjore përkatëse, të cilat operacionalizojnë në praktikë mekanizmat institucionale dhe procedurat për trajtimin e rasteve.

Në këtë kontekst, projektvendimi synon rregullimin e detajuar të organizimit, përbërjes dhe funksionimit të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) në nivel vendor, si instrumenti kryesor për koordinimin ndërinstitucional dhe menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Ai qartëson dhe standardizon rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve kryesore, si dhe vendos procedura të unifikuar për bashkërendimin dhe koordinimin ndërinstitucional, duke garantuar një qasje të integruar me në qendër viktimën.

Gjithashtu, projektakti parashikon masa konkrete dhe procedura të harmonizuara për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve, sigurimin e mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat, sistem të strukturuar gadishmërie, shmangien e viktimizimit dytësor, si dhe ndjekjen dhe monitorimin efektiv të urdhrave të mbrojtjes, në përputhje me legjisllacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”

Përcaktimi i përbërjes, funksionimit, detyrave dhe përgjegjësive të MKR lidhur me referimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, reflekton qëllimin e hartimit të këtij akti, propozuar në bazë dhe për zbatim të pikës 4, të nenit 56, të ligjit nr. 11/2026, “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”.

Projektvendimi ka qëllim të përcaktojë jo vetëm bashkëpunimin dhe koordinimin e të gjithë institucioneve përbërëse të MKR, si dhe ndërveprimin e autoriteteve vendore të MKR me autoritetet qendrore dhe subjekte të tjera, por edhe të sigurohet në marrjen e të gjitha masave të nevojshme për zbatimin e qasjes së integruar me në qendër viktimën ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke promovuar barazinë gjinore dhe eliminuar të gjithë format e diskriminimit ndaj grave.

Pavarësisht përmirësimit të kuadrit ligjor ndër vite, praktika e deritanishme ka evidentuar një sërë problematikash në funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit në nivel vendor, të cilat ndikojnë në efektivitetin e mbrojtjes së viktimave, si:

- mungesa e një koordinimi të qëndrueshëm dhe efektiv ndërinstitucional;
- qartësimi i pamjaftueshëm i roleve dhe përgjegjësive të institucioneve pjesëmarrëse;
- zbatim jo i njëtrajtshëm i procedurave për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve;
- kapacitete të kufizuara njerëzore dhe teknike në disa njësi të vetëqeverisjes vendore;
- vështirësi në ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes;
- mungesë e standardizimit të praktikave në nivel vendor;
- rrezik i shtuar i riviktimizimit për shkak të mungesës së një përgjigjeje të koordinuar dhe të orientuar drejt viktimës.

Këto problematika lidhen kryesisht me mungesën e një rregullimi të detajuar nënligjor që të përcaktojë në mënyrë të qartë procedurat, përgjegjësitë dhe mekanizmat e koordinimit ndërmjet institucioneve, duke krijuar boshllëqe në zbatimin praktik të legjislationit në fuqi.

Në këtë kontekst, miratimi i këtij projektvendimi paraqitet si një ndërhyrje e domosdoshme për adresimin e këtyre problematikave dhe për garantimin e një funksionimi efektiv, të koordinuar dhe të standardizuar të MKR-së në të gjithë territorin e vendit.

Projektvendimi paraqet disa përparësi thelbësore, ndër të cilat:

- operacionalizon në praktikë zbatimin e ligjit nr. 11/2026 në nivel vendor;
- qartëson strukturën dhe funksionimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit;
- forcon rolin e Koordinatorit Vendor, si hallkë kyçe në menaxhimin e rasteve;
- standardizon procedurat për trajtimin dhe ndjekjen e rasteve të dhunës;
- garanton një qasje të integruar dhe me në qendër viktimën;
- përmirëson bashkëpunimin ndërinstitucional dhe me organizatat e shoqërisë civile;
- rrit transparencën, përgjegjshmërinë dhe efektivitetin e institucioneve përgjegjëse.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”

Zbatimi i këtij projektvendimi pritet të sjellë efekte konkrete dhe të matshme, si:

- përmirësim të ndjeshëm të koordinimit ndërinstucional në trajtimin e rasteve;
- rritje të aksesit të viktimave në shërbime të integruara dhe të specializuara;
- rritje të efektivitetit në zbatimin dhe monitorimin e urdhrave të mbrojtjes;
- forcim të kapaciteteve të autoriteteve vendore për menaxhimin e rasteve;
- reduktim të rasteve të riviktimizimit dhe rritje të mbrojtjes së viktimave;
- harmonizim të praktikave në nivel vendor me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- përmirësim të përgjigjes dhe gadishmërisë institucionale ndaj të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Në këtë kuadër, projektvendimi kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin në praktik të dispozitave e ligjit nr.11/2026 dhe në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, përfshirë përafrimin me Direktivën e BE-së nr. 1385/2024, “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, duke forcuar dimensionin institucional dhe operacional të mekanizmave të mbrojtjes në nivel vendor.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, si dhe në zbatim të pikës 4, të nenit 56, të ligjit nr. 11/2026, “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, i cili autorizon Këshillin e Ministrave të përcaktojë përbërjen, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit.

Projektvendimi është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në veçanti me parimet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazinë përpara ligjit dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Ai është gjithashtu në përputhje dhe në harmoni me legjislacionin vendas në fuqi, në veçanti me:

- ligjin nr. 11/2026 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”;
- legjislacionin për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin;
- legjislacionin për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore;
- legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Projektvendimi nuk është në kundërshtim me aktet e tjera normative në fuqi dhe kontribuon në zbatimin e tyre në mënyrë të koordinuar dhe të standardizuar në nivel vendor.

Në aspektin e harmonizimit me legjislacionin ndërkombëtar, projektvendimi është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, në veçanti:

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”

- Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit);
- Konventën e Kombeve të Bashkuara për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAË).
- Konventën nr.190 “Mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës”, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Gjithashtu, projektvendimi është në linjë me procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian, në veçanti me Direktivën e BE-së nr. 1385/2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, duke kontribuar në forcimin e kuadrit institucional dhe procedural për zbatimin e saj në praktikë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-së

Detyrimi për të përafuar legjislacionin shqiptar me acquis të bashkimit Evropian, në veçanti në kuadër të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, buron nga nenet 70 dhe 75 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Këto dispozita parashikojnë detyrimin për përafrimin progresiv të legjislacionit vendas me atë të BE-së dhe sigurimin e zbatimit efektiv të tij në praktikë.

Në këtë kuadër, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi ligji nr. 11/2026 “Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, i cili është përafuar pjesërisht dhe Direktivën (BE) 2024/1385 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 14 maj 2024, “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

Në zbatim të këtij ligji dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përafrimit, projektvendimi ka për objekt përcaktimin e rolit, përbërjes, funksionimit dhe përgjegjësisë të MKR-së, me qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Projektvendimi nuk përbën në vetvete një akt përafrimi të drejtpërdrejtë me acquis të BE-së, por kontribuon në zbatimin praktik të dispozitave të ligjit të përafuar pjesërisht me Direktivën e BE-së nr. 1385/2024, duke forcuar dimensionin institucional dhe procedural të mekanizmave të mbrojtjes në nivel vendor.

Në këtë mënyrë, projektvendimi ndikon në rritjen e nivelit të përputhshmërisë de facto me acquis të BE-së, nëpërmjet sigurimit të një zbatimi më efektiv, të koordinuar dhe të standardizuar të legjislacionit në fuqi.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është organizuar në shtatë krerë dhe një aneks me përkufizime. Secili kre i projekt vendimit është i ndarë në nene me pika e paragrafë përkatës.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”

Kreu I i projektvendimit titulluar “*Dispozita të përgjithshme*” [nenet 1-5] parashikon objektin dhe qëllimin e vendimit, si dhe përkufizon institutet e sanksionuara në dispozitat vijuese.

Në vijim parashikohet përbërja e MKR-së, që krijohet pranë çdo bashkie në rang vendi. Gjithashtu, listohen në mënyrë të detajuar parimet mbi të cilat bazohet veprimtaria e MKR-së, ku parimi kryesor është trajtimi i rasteve të dhunës përmes qasjes me në qendër viktimën, duke shmangur viktimizimin dytësor.

Risi e këtij projektvendimi, që pasqyron dhe frymën e ligjit në bazë e për zbatim të të cilit po miratohet, është theksi se gjithë procesi i parandalimit, mbrojtjes, mbështetjes, rehabilitimit dhe riintegritimit të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, trajtimi i barabartë, mbrojtja nga diskriminimi, konfidencialiteti, shërbime lehtësisht të aksesueshme, si dhe standardizimi i procedurave për koordinimin ndërinstitutional.

Kreu II i projektvendimit sanksionon “*Përbërjen, detyrat dhe funksionimin e Komitetit Drejtues*” [nenet 6-12]. Përcaktohet në mënyrë të qartë, përbërja, funksionimi dhe detyrat e Komitetit Drejtues (KD) si organ kyç në bashkërendimin e veprimtarisë ndërinstitutionale në nivel vendor për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Projektvendimi parashikon një përfaqësim të gjerë ndërinstitutional në përbërje të KD, ku tek anëtarët e përhershëm përfshihen autoritetet e qeverisjes vendore, institucionet e drejtësisë, shërbimet sociale, shëndetësore dhe arsimore, si dhe organizatat e shoqërisë civile. Qëllimi i kësaj përbërjeje kaq të gjerë institutionale është garantimi i qasjes së koordinuar dhe gjithëpërfshirëse. Ndërkohë, në rastet ku nevojitet KD ka dhe një sërë anëtarësh *ad hoc*, të cilët mund të ftohen për pjesëmarrje kur është nevoja. Projektvendimi përcakton dhe procedurën e përzgjedhjes së organiztave jofitimprurëse pjesë e KD.

KD shërben si mekanizëm për lidhjen midis nivelit vendor dhe politikëbërjes qendrore, përmes raportimit dhe adresimit të problematikave sistematike. Gjithashtu, nëpërmjet KD sigurohet drejtimi strategjik, monitorimi i zbatimit të legjislacionit, identifikimi i problematikave dhe përmirësimi i politikave në nivel vendor, ndërgjegjësimi për parandalimin e dhunës, si dhe mbështetja institutionale e financiare për funksionimin efektiv të mekanizmit. Një ndër detyrat e KD është dhe parashikimi buxhetor për rastet emergjente, për qëllimet operative dhe për shportën e shërbimeve emergjente.

Gjithashtu, detajohen aspektet procedurale të mbledhjeve, vendimmarrjes dhe raportimit të KD, me qëllim sigurimin e transparencës duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave personale të viktimave.

Kreu III i projektvendimit parashikon rregullimet në lidhje me “*Përbërja, detyrat dhe funksionet e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor (ETN)*” [nenet 13-18].

Këto nene përcaktojnë ngritjen, përbërjen, funksionimin dhe detyrat e ETN-së si strukturë operative për menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në nivel vendor si dhe ndjekjen e vazhdueshme të rasteve deri në mbylljen e tyre. Ngritja e ETN-së parashikohet të kryhet me vendim të KD, nën drejtimin e Koordinatorit Vendor, duke garantuar një përfaqësim të gjerë teknik nga institucionet përgjegjëse. ETN-së garanton një trajtim të

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”

koordinuar dhe integruar të rasteve, përmes vlerësimit dhe menaxhimit të riskut, hartimit dhe zbatimit të planeve të ndërhyrjes, si dhe sigurimit të një aksesit efektiv në shërbime mbështetëse për viktimat. Projektvendimi garanton informimin dhe përfshirjen e viktimës në planin e ndërhyrjes, duke konkretizuar më tej zbatimin e parimit me në qendër viktimën.

Projektvendimi parashikon në mënyrë të detajuar funksionimin e ETN-së nga pikëpamja procedurale, bashkëpunimin ndërinstytucional dhe raportimin periodik pranë KD, duke siguruar zbatimin e qasjes me në qendër viktimën, respektimin e konfidencialitetit dhe shmangien e viktimizimit për herë të dytë. Rol i veçantë i është atribuar punonjësit social në identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve, si dhe në koordinimin e shërbimeve përkatëse. Në kuadër të koordinimit për rastet e dhunës, projektvendimi krijon një sistem gadishmërie 24 orësh lidhur me shërbimet e mbrojtjes dhe reagimit emergjent, si dhe vendos limite kohore për reagim.

Kreu IV i projektvendimit sanksionon detyrat e “*Koordinatori vendor*” [nenet 19-26]. Projektvendimi përcakton në mënyrë të detajuar rolin, organizimin dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Vendor (KV) si strukturë kyçe në funksionimin efektiv të MKR-së, lidhur me trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në nivel vendor. KV parashikohet të caktohet pranë çdo bashkie të vendit, duke marrë në konsideratë edhe faktorët e tillë si numri i popullsisë dhe rastet e dhunës në territorin përkatës. Bashkitë duhet të garantojnë mbështetjen e nevojshme institucionale dhe logjistike për ushtrimin e funksioneve të KV në mënyrë të pavarur dhe efektive. KV përbën pikën qendrore të koordinimit të të gjithë mekanizmit dhe garanton funksionimin e vazhdueshëm të tij në praktikë.

Përmes KV do të sigurohet koordinimi i veprimtarisë ndërmjet institucioneve, drejtimi i ETN-së, si dhe ndjekja dhe menaxhimi i rasteve në mënyrë të integruar përmes qasjes me në qendër viktimën. Gjithashtu, projektakti rregullon aksesin e KV në informacion nga institucionet përgjegjëse, duke mundësuar ndjekjen e plotë të historikut të rasteve dhe garantimin e një vlerësimi të koordinuar të riskut.

KV ka detyra të gjera në koordinimin e ndërhyrjeve, sigurimin e aksesit të viktimave në shërbime mbështetëse, ndërmjetësimin ndërinstytucional dhe garantimin e reagimit të menjëhershëm në rastet me risk të lartë. Një rëndësi e veçantë i jepet rolit të KV në asistimin e viktimave për marrjen dhe zbatimin e urdhrave të mbrojtjes të të gjitha llojeve që parashikon ligji, monitorimin e tyre dhe koordinimin me organet e drejtësisë dhe Policinë e Shtetit, duke garantuar sigurinë e viktimave, si aspekt thelbësor për trajtimin e rasteve të dhunës.

Projektvendimi sanksionon detyrat e KV në lidhje me raportimin, hartimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, zhvillimit të shërbimeve vendore, si dhe organizimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe trajnimeve për institucionet e struktura komunitare. Gjithashtu, parashikohen në mënyrë të detajuar procedurat përkatëse për organizimin e mbledhjeve, përpunimin dhe raportimin e të dhënave, si dhe hartimi statistikave për rastet e dhunës përmes

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse”

përdorimit të sistemeve elektronike të dedikuara, me qëllim përmirësimin e politikave në nivel vendor.

Projektvendimi forcon rolin koordinues të KV, si dhe rrit efektivitetin e mekanizmit për të siguruar një reagim të shpejtë, të koordinuar dhe gjithëpërfshirës për të gjithë format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Kreu V i projektvendimit sanksionon "*Rregulla të përgjithshme për menaxhimin e rastit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*" [nenet 27-32].

Në këtë kapitull projektvendimi parashikon rregullat e përgjithshme për menaxhimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke përcaktuar një kuadër procedural të unifikuar, i cili nuk varion sipas formës së dhunës apo kontekstit specifik ku ndodh dhuna. Këto rregulla sigurojnë një qasje të unifikuar në trajtimin e rasteve në të gjithë territorin e vendit. Parimi kryesor ku mbështeten këto rregulla është qasja me në qendër viktimën, duke respektuar dinjitetin, sigurinë dhe nevojat e saj, duke shmangur riviktimizimin dhe vlerësuar riskun me qëllim garantimin e një ndërhyrjeje të menjëhershme dhe efektive.

Në këto dispozita parashikohet e drejta e viktimave për të raportuar dhunën pranë çdo autoriteti edhe përmes mjeteve elektronike, duke siguruar kështu akses, por edhe siguri dhe mbrojtje të të dhënave personale. Vëmendje e veçantë i kushtohet grupeve në nevojë.

Dispozitat e këtij kreu rregullojnë trajtimin e rasteve specifike të dhunës për të gjitha vajzat dhe gratë, përfshirë shtetasit e huaja dhe personat pashtetësi.

Në këto dispozita trajtohet dhe dhuna e lehtësuar nga teknologjia, për të cilën parashikohen mekanizma të sigurt raportimi dhe mbrojtjeje përmes kanaleve të posaçme. Gjithashtu, parashikohen rastet e dhunës ndaj grave në proceset zgjedhore dhe jetën politike, ku sigurohet akses në mjetet mbrojtëse.

Projektvendimi përmban dispozita të posaçme për dhunën, ngacmimin dhe ngacmimin seksual, duke parashikuar rolin e KV në orientimin e viktimave drejt mekanizmave raportues të brendshme ose të jashtme, ofrimin të mbështetjes ligjore dhe shërbimeve, si dhe mbledhjen e ruajtjen e provave.

Kreu VI i projektvendimit sanksionon "*Procedura bazë për menaxhimin e rastit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*" [nenet 33-34].

Në këtë pjesë të projektvendimit detajohet procedura bazë për vënien në lëvizje të MKR dhe menaxhimi fillestar i rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke garantuar reagim të shpejtë dhe të koordinuar të të gjithë institucioneve përgjegjëse, si dhe duke siguruar reagim të menjëhershëm në rastet me risk të lartë. Në këto dispozita parashikohet se të gjitha rastet e dhunës mund të raportohen pranë çdo autoriteti kompetent, cili ka për detyrë të marrë masa për mbrojtjen e viktimës, vlerësimin e riskut dhe referimin për shërbime specifike mbështetëse.

Ndërkohë, KV merr masa për koordinimin ndërinstucional dhe ndjekjen e rastit. Këto dispozita parashikojnë se menaxhimi i rastit kryhet në bazë të vlerësimit individual të riskut

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse"

dhe planit të përbashkët të ndërhyrjes, duke siguruar mbrojtje, trajtim dhe rehabilitim të viktimës konform legjislacionit në fuqi.

Në këtë kre të projektvendimit parashikohet procedura e përgjithshme e trajtimit të formave specifike të dhunës, të tilla si ajo në vendin e punës, në jetën publike dhe dhuna e lehtësuar nga teknologjia, duke siguruar të drejtën e viktimave për raportim, akses dhe mbrojtje në shërbimet e posaçme.

Kreu VII sanksionon "*Dispozita të fundit*" ku në pikat 1-4 përcaktonhet detyra të posaçme për institucionet përgjegjëse, si dhe përcaktohet detyrimi për monitorimin e zbatimit të këtij projektvendimi nga autoritetet përgjegjëse. Pika 1 e këtij kreu sanksionon se ministria ose ministri përgjegjës për çështje të barazisë gjinore duhet të miratojë formatin e protokollit të menaxhimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në kuadër të MKR. Ngarkon autoritetet përgjegjëse për zbatimin e këtij projektvendimi sikurse janë njësitë e vetëqeverisjes vendore, ministrinë përgjegjës për çështje të barazisë gjinore të hartojnë dhe miratojnë procedurat standarde të veprimit, protokollat dhe standardet përkatëse për zbatimin e këtij projektvendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektakti janë: njësitë e vetëqeverisjes vendore, Ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, institucionet në vartësi të tyre që lidhen me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të gjitha institucionet dhe strukturat pjesë e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, sipas përcaktimeve të këtij projektvendimi.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe është konsultuar me përfaqësues të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR) dhe të organizatave jofitimprurëse, që punojnë në fushën e mbrojtjes nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.

Projektvendimi dërgohet për mendime në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor, Ministrinë e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe institucioneve të tjera përgjegjëse dhe të interesuara, në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse"

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Llogaritja e efektit financiar u mbështet në analizën e bërë për kostimin e projekt VKM-së "Mbi përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të Rasteve të Dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës të autoriteteve përgjegjëse". Shpenzimet indikative për zbatimin e projekt vendimit do të përballohen nga buxheti i NJQV dhe fondet do të alokohen nga programi buxhetor mbi mbrojtjen sociale.

Vlerësimi ka mbajtur në konsideratë vetëm shpenzimet indikative shtesë, të cilat do të përballohen nga programet buxhetore respektive të secilës bashki. Në këtë analizë u vlerësuan shpenzimet vjetore, në një format që mbështet dhe/ose orienton NJQV për planifikimin e buxhetit vjetor. Shpenzimet që do të alokohen nga secila bashki janë kryesisht shpenzime që mundësojnë realizimin e detyrave që projekt vendimi i ka përcaktuar Koordinatorëve Vendor. Planifikimi i shpenzimeve u mbështet në dy kritere: numrin e popullsisë dhe numrin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Sipas të dhënave të raportuara në MSHMS të gjitha bashkitë kanë emëruar një Koordinator Vendor. VKM parashikon që numri i KV të përcaktohet me vendim të Këshillit Bashkiak. Për bashkitë me mbi 80 mijë banorë kërkohet të krijohet një njësi me jo më pak se 2 (dy) koordinatorë. Mbështetur në të dhënat e INSTAT mbi numrin e popullsisë dhe numrin e rasteve të raportuara rezultojnë që 6 Bashki (Durrësi, Elbasani, Fieri, Korça, Shkodra dhe Vlora) duhet të krijojnë njësi me të paktën 2(dy) koordinatorë vendorë. Ndërsa Bashkia Tiranë duhet të krijojë një njësi me të paktën 4 (katër) koordinatorë vendorë pasi ka numrin më të madh të banorëve dhe rreth 40 përqind të rasteve të raportuara të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Në total duhet të rritet me 10 numri i koordinatorëve vendor.

Efekti i përgjithshëm financiar vjetor është vlerësuar 92,855,466 lekë i shpërndarë në disa kategori shpenzimesh, si paga dhe shtesat mbi paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime të tjera operative.

Më poshtë janë paraqitur të detajuara shpenzimet vetëm për ato zëra që kërkojnë shpenzime indikative shtesë:

1. Pagat, shtesat mbi pagat dhe sigurimet shoqërore & shëndetësore - shpenzimet vjetore për 10 koordinatorë vendorë në total janë vlerësuar 13,863,960 lekë ose mesatarisht 1,386,396 për 1 (një) koordinatorë vendor.

2. Pagesa shtesë për punën jashtë orarit, punën në fundjavë apo në ditët e festave – parashikimi është bërë për jo më shumë se 1(një) ditë në muaj për çdo KV në 61 Bashki. Efekti total është 3,465,990 lekë ose mesatarisht 61,893 lekë për KV.

Relacion shpjegues për projektvendimin "Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe bashkërendimin e punës së autoriteteve përgjegjëse"

3. **Shpenzime të tjera operative për ndjekjen dhe monitorimin e rasteve** – parashikimi është bërë për 61 bashki. Efekti total është vlerësuar 68,325,516 lekë ose mesatarisht rreth 14,300 lekë në muaj për secilin KV. Shpenzimet janë indikative dhe bashkitë mund t'i rivlerësojnë në varësi të numrit të rasteve.
4. **Trajnimi i KV dhe antarëve të Ekipeve Teknike Ndërdisciplinore.** Miratimi i VKM duhet të vazhdojë me trajnime të stafeve. Parashikohet trajnimi i 300 personave në vit (trajnime 2 ditore), për të paktën 3 vjet. Kostoja vjetore 7,200,000 lekë. Shpenzimet për trajnime nuk janë parashikuar në buxhetet e NJQV.

Shpenzimet për aktivitete të tjera do të mbulohen me burimet njerëzore dhe financiare të miratuara në buxhetin vjetor dhe PBA 2027-2029 të NJQV.

PROPOZUESI

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

EVIS SALA

